



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201500683/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** *Rekomandim për analizimin e ngjarjes së ndodhur në qytetin e Kukësit në datën 04.05.2015, nxjerrjen e përgjegjësive dhe trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit.*

**Drejtuar :** **Drejtorit të Policisë së Shtetit**  
**Z. Haki ÇAKO**

**Tiranë**

***I nderuar zoti Çako,***

Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar me iniciativë rastin e bërë publik në datën 04.05.2015 nga disa TV vendase të dhunimit fizik të shtetasit N.L. nga një punonjës i Komisarariatit të Policisë Kukës.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti të bërë nga punonjësit e institucionit tonë, si pyetja e drejtuesve të Policisë së Qarkut Kukës, të Komisarariatit të Policisë Kukës, të disa punonjësve të policisë së këtij organi që kishin marrë pjesë në shërbim e organizuar me rastin e një tubimi që ishte organizuar nga disa shtetas në këtë qytet në datën 04.05.2015, e shtetasit të arrestuar N.N., i cili ndodhej në ambientin e sigurisë të këtij organi, si dhe nga dokumentacioni i administruar rezultoi se:

Shtetasi N.L. me banim në qytetin e Kukësit, në datën 30.04.2015 i ka dërguar dy njoftime Komisarariatit të Policisë Kukës për të zhvilluar dy tubime në datën 04.05.2015 respektivisht, njërin në orën 11:00 tek shkallët e Pallatit të Kulturës "Hasan Prishtina", Kukës dhe tjetrin në orën 12:00 tek ura mbi Lumin Drin ku do të bllokoni trafikun për 10 minuta në Rrugën e Kombit.

Komisariati i Policisë Kukës me shkresën nr. 1557/1 Prot., datë 03.05.2015 i ka kthyer përgjigje shtetasit N.L. duke e informuar atë, se nuk ia miratuan lejen për zhvillimin e tubimit të kërkuar prej tij duke i dhënë edhe sqarimet ligjore përkatëse.

Shtetasi N.L. megjithëse e ka marrë përgjigjen e policisë për refuzimin e zhvillimin e tubimit, në fakt e ka zhvilluar atë sepse sipas tij, ai kishte njoftuar mediat dhe se arsyet e refuzimit i ka konsideruar të padrejta.

Drejtorja e Policisë së Qarkut Kukës, duke vlerësuar thirrjet në media të shtetasit N.L. për veprime të dhunshme, një ndër të cilat ka qënë edhe nëpërmjet TV Klan në emisionin “Zona e lirë” e moderatorit Arjan Çani, si dhe duke vlerësuar edhe aktivitetin e mëparshëm të këtij personi që kishte organizuar disa tubime nga të cilat disa me leje dhe disa pa leje, kishte përgatitur një Plan - Masash të miratuar në datën 03.05.2015 “Për sigurimin e rendit dhe të qetësisë publike dhe parandalimin e ngjarjeve kriminale në tubimin që do të zhvillohej në datën 04.05.2015 ora 11:00-12:30”.

Në datën 04.05.2015, rreth orës 11:00, shtetasi N.L. e ka organizuar tubimin në shkallët e Pallatit të Kulturës “Hasan Prishtina”, Kukës, ku kanë marrë pjesë rreth 200-300 persona. Në këtë tubim ai ka folur para pjesëmarrësve duke kërkuar nga qeveria faljen e debive dhe kamatvonesave të energjisë elektrike për familjarët dhe bizneset e rretheve Kukës dhe Has. Gjithashtu ai është shprehur para tubuesve se, Policia e Shtetit është kriminale, se do të rrëzojnë kriminelët nga pushteti, poshtë Edi Rama dhe Ilir Meta etj, si dhe ka bërë thirrje pjesëmarrësve për të shkuar e bllokuar Rrugën e Kombit.

Pas rreth 30 minutash, me thirrjen e tij, rreth 80 tubues u nisën për të bllokuar Rrugën e Kombit tek ura mbi Lumin Drin, duke kaluar përmes një pylli. Gjatë rrugës tubuesit kanë marrë gurë e shkopinj dhe kanë zbritur në rrugën e qytetit Kukës, rreth 50 metra në afërsi të urës mbi Drin. Disa prej tyre kanë hedhur gurë në rrugë dhe shkopinj e drunj të ndryshëm duke bllokuar rrugën për në qytet.

Drejtuesit e policisë u kanë bërë thirrje organizatorit të tubimit, shtetasit N.L. dhe pjesëmarrësve në tubim që të ndalonin kryerjen e veprimeve të kundërligjshme dhe të shpërndaheshin. Por ata nuk u janë bindur thirrjeve të policisë dhe ndërkohë kanë ushtruar dhunë fizike duke i shtyrë dhe goditur me gurë, shkopinj dhe tabela disa nga punonjësit e policisë të cilët ishin vendosur në rrugë për të mos lejuar tubuesit për të shkuar dhe bllokuar Rrugën e Kombit.

Ndodhur në këto rrethana, Shefi i Rendit i Komisarariatit të Policisë Kukës Adem Visha e ka kapur shtetasin N.L. nga trupi dhe i ka kërkuar që të shoqërohet në komisarariat për shkak se kishte konsumuar veprat penale të “Thirrjes publike për veprime të dhunshme”, “Kundërshtimit të punonjësve të policisë së rendit”, “Organizimit dhe pjesëmarrjes në tubim të paligjshëm” dhe “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit”. Shtetasi N.L. nuk u është bindur thirrjes së policisë për t’u shoqëruar në komisarariat dhe ka bërë rezistencë fizike duke u shtrirë në rrugë. Në këtë moment kanë ndërhyrë edhe punonjësit e policisë Gazment Trota dhe Shkëlzen Neza të cilët kanë tentuar që ta prangosin shtetasin N.L.. Për shkak të rezistencës së tij dhe të dhunës së tubuesve ndaj policisë ata nuk kanë mundur ti vendosin prangat atij. Ndodhur në këto rrethana punonjësit e policisë e kanë kapur shtetasin N.L. nga krahët dhe këmbët dhe me forcë e kanë futur në makinën e policisë.

Nga transmetimet televizive shikohet e dëgjohet që gjatë këtyre momenteve, Shefi i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisarariatit të Policisë Kukës Albion Xhitoni ka nxjerr pistoletën nga brezi dhe e ka mbushur atë, si dhe u drejtohet qytetarëve tubues me fjalë fyese. Gjithashtu nga pamjet filmike të transmetuara nga disa TV rezulton se, në momentin e futjes së shtetasit N.L. në makinën e policisë, punonjësi i policisë Albion Xhitoni e ka goditur atë me

grusht në trup. Pas futjes në makinë, punonjësit e policisë e kanë shoqëruar shtetasin N.L. në Komisaratin e Policisë Kukës ku kanë kryer veprime procedurale.

Në komisarati shtetasi N.L. është arrestuar në kushtet e flagrancës për disa vepra penale, si “Thirrjes publike për veprime të dhunshme”, “Kundërshtimit të punonjësve të policisë së rendit”, “Organizimit dhe pjesëmarrjes në tubim të paligjshëm” dhe “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit”, parashikuar nga nenet 223, 236, 262 dhe 293 të Kodit Penal.

Drejtoria e Policisë së Qarkut Kukës me shkresën nr. 1600/1 Prot., datë 04.05.2014 materialet procedurale në ngarkim të shtetasit N.L. ia ka dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Nga verifikimi i bërë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës rezultoi se, ky organ ka regjistruar procedimin penal nr. 192, datë 04.05.2015 ndaj personit nën hetim shtetasit N.L. për veprat penale ta parashikura nga nenet 223 dhe 262 të Kodit Penal.

Shefi i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Kukës Albion Xhitoni në deklaratimet e tij mohoi faktin e ushtrimit të dhunës fizike ndaj shtetasit N.L. dhe ndërkohë pretendoi se armën e nxori për shkak se një person i panjohur nga tubuesit tentoi t’ja merrte atë nga brezi. Gjithashtu ai mohoi edhe faktin se ka përdorur fjalë fyese ndaj qytetarëve tubues.

Pavarësisht mohimit të tij që ka përdorur fjalë fyese ndaj qytetarëve dhe e ka dhunuar fizikisht shtetasin N.L., nga pyetja e këtij të fundit dhe nga pamjet filmike të transmetuara nga disa TV rezultoi se, Shefi i Seksionit për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Kukës Albion Xhitoni ka fyer qytetarët dhe e ka goditur me grusht shtetasin N.L. në momentin e futjes së këtij të fundit në makinën e policisë. Sqarojmë se, nga këqyrja që iu bë shtetasit N.L. nga punonjësit tanë nuk rezultoi që ai të kishte shenja dhune në trup, ku pretendonte se ishte goditur me grushta vetëm nga një punonjës policie civil në momentin e futjes në makinën e policisë.

Ne konstatojmë se veprimet e kryera nga punonjësi i policisë Albion Xhitoni nuk janë në përputhje me rregullat e parashikuara në aktet normative në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

Sjellim në vëmendje se, në bazë të nenit 2 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, *Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Ndërsa sipas nenit 94 të këtij ligji, punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave.*

Nga hetimi i kryer konstatojmë se, në rastin konkret punonjësit e policisë kanë ushtruar të drejtën ligjore për të përdorur forcën me qëllim shoqërimin në organin e policisë të shtetasit N.L. dhe për largimin e disa shtetasve të cilët po pengonin punonjësit e policisë që të kryenin detyrën ligjore.

Në përfundim të këtij hetimi administrativ kemi arritur në konkluzionin se, veprimi i punonjësit të policisë Albion Xhitoni duke e goditur me grusht në trup shtetasin N.L. përmban elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Për këtë arsye me shkresën nr. K2/I13-2 Prot., datë 08.05.2015 i kemi rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës fillimin e hetimeve ndaj punonjësit të policisë Albion Xhitoni për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

Ndërkohë konstatojmë se, veprimet fyese të punonjësit të policisë Albion Xhitoni ndaj qytetarëve tubues vijnë në kundërshtim me etikën e punonjësit të Policisë së Shtetit. Ndërsa nxjerrja e pistoletës nga brezi dhe mbushja e saj vjen në kundërshtim me Urdhrin nr. 1417, datë 11.12.2009 të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Për Miratimin e Procedurave Standarde të Departamentit të Sigurisë Publike”, sepse në rrethanat konkrete ai nuk ndodhej në kushtet e përdorimit të armës së zjarrit dhe për rrjedhojë nuk kishte arsye që ta nxirrte dhe mbushte atë.

Veprimet e punonjësit të policisë Albion Xhitoni, të cilat i përshkruam më sipër janë tregues i humbjes së kontrollit dhe të qetësisë së tij gjatë kryerjes së detyrës ligjore.

Ne vlerësojmë se, sjellja e punonjësit të policisë Albion Xhitoni cënon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek ky organ.

Sqarojmë se, nga Drejtori i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Kukës u informuam se punonjësi i policisë Albion Xhitoni është pezulluar nga detyra deri në përfundim të ecurisë disiplinore të filluar për shkak të shkeljeve të procedurave standarde.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut, nga administrate publike”*, dhe në nenin 21/c të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“ Në përfundim të kryerjes së hetimeve Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Analizimin e ngjarjes së ndodhur në qytetin e Kukësit në datën 04.05.2015 dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.

2. Marrjen e masave të nevojshme për trajtimin e punonjësve të Policisë së Shtetit me qëllim zbatimin e rregullave të sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të kontrollit të veprimeve të tyre gjatë tubimeve të organizuara nga qytetarë të ndryshëm me ose pa miratimin e organeve të policisë

3. Ky rast të përgjithësohet në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim parandalimin në të ardhmen të veprimeve të tilla të pahijshme dhe të padenja për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda 30 ditëve konform nenit 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

## **AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**